



BASHKIA KORÇË

2022

Dokument mbi mekanizimin e llogaridhënies së SHMFF

PROCESI MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT
NISMA PËR NDRYSHIM SHOQËROR ARSIS PËR SHMFF,
BASHKIA KORÇË



BASHKIA KORÇË

MONITORIMI DHE VLERËSIMI I OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PRANË SHMFF

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet shoqatës Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS dhe Bashkisë Korçë e lidhur me datë 13.07.2021 me nr.prot 6013 dhe nr.101 prot,(NISMA) dt.15.07.2021 për zbatimin e projektit *“Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)* me mbështetje të Fondit Social (2021-2023), ekipi i Nisma ARSIS ka hartuar dokumentin për procedurat për monitorimin dhe vlerësimin e ofrimit të shërbimeve pranë SHMFF.

Hartimi i dokumentit bazohet në nenin 4 të marrëveshjes dhe në zbatim të aktivitetit *“hartimi i protokolleve, procedurave dhe manualeve të shërbimit, përfshirë dhe mekanizmat e llogaridhënies”*

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit shërben për të siguruar cilësinë dhe impaktin e një shërbimi për fëmijët, të rinjtë dhe familjet e tyre nëpërmjet mbledhjes së të dhënave dhe matjes së progresit të objektivave të përcaktuar.

Monitorimi dhe vlerësimi janë mekanizma të cilët kryhen në intervale kohore duke matur indikatorët e përcaktuar gjatë ofrimit të shërbimit dhe duke vlerësuar impaktin e shërbimeve me qëllim përmirësimin e tyre ndaj përfituesve të shërbimeve shoqërore.

Ngritja e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen si një model i cili pilotohet në nivel vendor e ka shumë të rëndësishëm funksionimin mbi bazën e disa protokolleve të rëndësishme të punës dhe mekanizmave të cilët garantojnë ofrimin në kohë dhe në cilësi të të gjithë gamës së shërbimeve. Për këtë qëllim ngritja e mekanizmit të monitorimit dhe vlerësimit duke përcaktuar edhe aktorët përgjegjës garanton zbatimin e instrumentave të nevojshëm që mundësojnë ndërhyrjet e nevojshme në gjurmimin e arritjeve, sfidave dhe sigurimin e evidencave deri në alokimin e burimeve ekzistuese. Proceset monitoruese dhe vlerësuese nëpërmjet raportimit lehtësojnë edhe vendim-marrjen e vazhdimësisë për ofrimin e shërbimit, mbështetjen dhe planifikimin e mëtejshëm.

Aktorët përgjegjës të përfshirë në këtë proces sistematik me qëllim garantimin e cilësisë së shërbimeve janë Bashkia Korçë dhe Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS të cilët kanë zhvilluar procedurat dhe manualët për menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e të gjithë shërbimeve sociale të ofruara në territorin e bashkisë nga shërbim ofruesit publikë dhe privatë. Në fazën e pilotimit të shërbimeve këto dy aktorë luajnë një rol të rëndësishëm në dhënien dhe transmetimin e modelit më të përshtatshëm të ngritjes së mekanizmit të vlerësimit dhe monitorimit.

Procesi i monitorimit zbatohet në dy nivele:



Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (*Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitucionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror*)Fondi Social 20212023
Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS

1. MEKANIZMI I MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT TË SHMFF NGA VETË PUSHTETI VENDOR, PËRKATËSISHT DREJTORIA E KUJDEMIT SOCIAL PRANË BASHKISË KORÇË.

SHMFF ka në proces monitorimi përformancën e shërbimit nga instrumentat e zgjedhur të Bashkisë Korçë nëpërmjet njësisë së posaçme e cila është përgjegjëse për prezantimin, mbikqyrjen dhe monitorimin e përformancës së shërbimit përfshirë edhe aspektin gjinor, bazuar në standartet vendore ose standartet minimale kombëtare.

Në procesin e monitorimit mund të përfshihen edhe aktorë të tjerë, të cilët do të angazhohen në zbatimin e këtij projekti si dhe ata të listuar me detyrën e monitorimit të Planit Social (ku përfshihen edhe drejtori të tjera të bashkisë dhe Grupi i Dialogut Social me Shoqata jo-publike partnere). Gjithashtu monitorimi parashikon edhe marrjen e masave korrigjuese ku ka devijime si edhe bën të mundur parashikimin e vështirësive para se të shfaqen.

Ai kryhet në intervale kohore mujore, tremujore, gjashtëmujore, vjetore dhe kërkon informacion nga tre fusha kryesore:

- Inputet, burimet që përdoren për realizimin e planit, që përfshijnë ekipin, financat, materialet dhe kohën;
- Proceset, numri i aktiviteteve ku përdoren burime njerëzore dhe financiare për të arritur rezultatet e pritshme;
- Outpute/produkte/shërbime, rezultatet e menjëhershme që përftohen përmes realizimit të aktiviteteve.

SHMFF është në varësi, dhe raporton tek Drejtori i Drejtorisë së Kujdesit Social në Bashkinë Korçë. SHMFF propozon çdo vit indikatorët e performancës dhe raporton në mënyrë periodike, të paktën 2 herë në vit, pranë Drejtorisë së Kujdesit Social. Përgjegjësi i SHMFF-së do të jetë anëtar i Grupit të Dialogut Social të ngritur në Korçë. Për qëllimet e këtij aplikimi indikatorët e performancës mbi të cilët do bëhet raportimi dhe vlerësimi janë si më poshtë:

Indikator 1: Ngritja e SHMFF dhe funksioneve të saj

Indikator 2: Ofrimi i programeve mbështetëse për familjet në nevojë – 160 familje

Indikator 3: Ofrimi i programeve për fuqizimin e familjes/prindërim pozitiv – rreth 150 familje

Indikator 4: Shtresa në nevojë (individë dhe familje) me të informuara për të drejtat e tyre – numri i fushatave ndërgjegjuese dhe informuese për çështje të shërbimeve të kujdesit shoqëror.



BASHKIA KORÇË

Mjetet për monitorim mund të jenë: analizat statistikore, vizitat monitoruese pranë SHMFF, pyetësorë drejtuar përfituesve të shërbimeve, minuta takimi, listë prezenca, foto, dosjet e përfituesve, fokus grupe me aktorë të ndryshëm/ përfitues, apo informatorë të tjerë kyç.

2

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (*Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror*)Fondi Social 20212023
Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



BASHKIA KORÇË

MATRICA E MONITORIM & VLERËSIMIT PËR PUNËN E SHMFF, BAZUAR NË OBJEKTIVAT DHE REZULTATET E PROJECT PROPOZIMIT

Objektivat e programit*	#	Rezultatet e pritshme*	Target (final)	Mjetet e verifikimit	Metoda e llogaritjes (procesimi dhe përpunimi I të dhënave të mbledhura)	Frekuenca e mbledhjes së të dhënave	Frekuenca e raportimit
Output 1: Parandalimi i ndarjes së fëmijëve nga prindërit dhe deinstitutionalizimi nëpërmjet riintegrit me familjet biologjike ose në familje kujdestare, duke garantuar sigurinë dhe mirëqënien e fëmijëve dhe familjeve të tyre përmes ngritjes së	1.1	<i>Nr. i familje janë mbështetur me shërbime proaktive dhe asistencë psiko-sociale, shërbime direkte</i> duke parandaluar institucionalizimin e fëmijëve dhe kthimin e fëmijëve në familje nga institucionet rezidenciale. <i>Të dhënat e segreguara në gjini, moshë, ak, etni, etj</i>	150	Raport pas cdo vizite monitoruese, foto, listë prezencë, procesverbale të ofrimit të shërbimit, Dosjet e përfituesve, databazë, minuta takimi , vizita në familje	Përpunimi i të dhënave bazohet në: Lista e pjesëmarrësve Prova të ofrimit të shërbimeve Dosjet e përfituesve Instrumentat e përdorur Raporte mbi vizitat monitoruese Focus grupe me fëmijë/të rritur/bashkëpunëtorë	Pas çdo aktiviteti	Çdo tremujor



BASHKIA KORÇË

shërbimeve të fuqizimit të familjes.	të të	1.2	150 familje janë identifikuar dhe asistuar me shërbime të integruara në familje	150	Raport pas çdo vizite monitoruese, foto, listë prezencë, procesverbale të	Përpunimi i të dhënave bazohet në: Lista e pjesëmarrësve	Pas çdo aktiviteti	Çdo tremujor
--------------------------------------	-------	------------	--	------------	---	---	--------------------	--------------

			dhe pranë institucioneve shërbim ofruese. <i>Të dhënat e segreguara në gjini, moshë, ak, etni, etj</i>		ofrimit të shërbimit, Dosjet e përfituesve, databazë, minuta takimi, vizita në familje	Prova të ofrimit të shërbimeve Dosjet e përfituesve Instrumentat e përdorur Raporte mbi vizitat monitoruese Fokus grupe me fëmijë/të rritur/bashkëpunëtorë		
--	--	--	--	--	--	--	--	--



BASHKIA KORÇË

Output 2: Familjet dhe fëmijët përfitojnë shërbime të specializuara që adresojnë nevojat e shfaqura në aspektin e shëndetit fizik dhe mendor, si edhe rritja e kapaciteteve të familjeve dhe ofrimi i mundësive për t'u rikuperuar gjatë fazave kur prindi nuk mund të	2.1	90 fëmijë kanë përfituar nga shërbime të specializuara për përmirësimin e gjendjes së tyre dhe sigurinë e një jete dinjitoze. Të dhënat e segreguara në gjini, moshë, ak, etni, etj	90	Raport pas çdo vizite monitoruese, foto, listë prezencë, procesverbale të ofrimit të shërbimit, terma reference Dosjet e përfituesve, databazë, minuta takimi , vizita në familje, mbledhje GTn, SVK,	Përpunimi I të dhënave bazohet në: Lista e pjesëmarrësve Prova të ofrimit të shërbimeve Dosjet e përfituesve Instrumentat e përdorur Minuta takimi të GTN, SVK, etc Raporte mbi vizitat monitoruese	Pas çdo aktiviteti	Çdo tremujor
ushtrojë përgjegjësitë e tij përmes ofrimit të shërbimeve mbështetëse në familje.					Focus grupe me fëmijë/të rritur/bashkëpunëtorë		



BASHKIA KORÇË

2.2	160 prindër kanë përfituar nga shërbime të specializuara për përmirësimin e gjendjes së tyre dhe sigurinë e një jete dinjitoze. <i>Të dhënat e segreguara në gjini, moshë, ak, etni etj</i>	160	Raport pas çdo vizite monitoruese, foto, listë prezencë, terma reference, procesverbale të ofrimit të shërbimit, Dosjet e përfituesve, databazë, minuta takimi , vizita në familje	Përpunimi I të dhënave bazohet në: Lista e pjesëmarrësve Prova të ofrimit të shërbimeve Dosjet e përfituesve Instruementat e përdorur Minuta takimi të GTN, SVK, etc Raporte mbi vizitat monitoruese Focus grupe me fëmijë/të rritur/bashkëpunëtorë	Pas çdo aktiviteti	Çdo tremujor
-----	---	-----	--	--	--------------------	--------------



BASHKIA KORÇË

	2.3	<i>Nr. i familjeve biologjike</i> që janë vlerësuar, trajnuar, mbështetur dhe supervizuar për ofrimin e një shërbimi cilësor/praktikave pozitive të prindërimit për fëmijët. <i>Të dhënat e segreguara në gjini, moshë, ak, etni etj.</i>	30	Raport pas çdo vizite monitoruese, foto, listë prezencë, procesverbale të ofrimit të shërbimit, Dosjet e përfituesve, databazë, minuta takimi , vizita në familje	Përpunimi I të dhënave bazohet në: Lista e pjesëmarrësve Prova të ofrimit të shërbimeve Dosjet e përfituesve Minuta takimi të GTN, SVK, etc Raporte mbi vizitat monitoruese Focus grupe me fëmijë/të rritur/bashkëpunëtorë	Pas çdo aktiviteti	Çdo tremujor
--	------------	--	-----------	--	---	-----------------------	-----------------



BASHKIA KORÇË

Output 3: Pilotimi i kujdesit alternativ profesional për fëmijët, prindërit e të cilëve nuk mund të ushtrojnë kujdes prindëror për një kohë të caktuar.	3.1	<i>Nr. i familjeve</i> janë identifikuar, trajnuar dhe pilotojnë shërbimin e kujdesit alternativ profesional. <i>Të dhënat e segreguara në gjini, moshë, ak, etni, etj</i>	3	Raport pas çdo vizite monitoruese, foto, listë prezencë, procesverbale të ofrimit të shërbimit, dosjet e përfituesve, databazë, minuta takimi , vizita në familje	Përpunimi i të dhënave bazohet në: Lista e pjesëmarrësve Prova të ofrimit të shërbimeve Dosjet e përfituesve Minuta takimi të GTN, SVK, etc	Pas çdo aktiviteti	Çdo tremujor
					Raporte mbi vizitat monitoruese		



BASHKIA KORÇË

FORMATI QË PËRDORET PËR DOKUMENTIMIN E RAPORTIT PËR VIZITËN MONITORUESE PËR NJË AKTIVITET TË CAKTUAR NGA ANE E DREJTUESIT TË DREJTORISË SË KÛJDESIT SOCIAL NË BASHKINË KORÇË

Raport mbi vizitën programatike të monitorim/vlerësimit

Projekti	
Kontrata nr.	
Objektivat	
Vendi	
Data	
Zhvilluar nga	

Agjenda

Plotësoni tabelën e mëposhtme sipas aajendës së planifikuar

Aktivitetet e mëposhtme janë plotësuar si pjesë e agjendës së vizitës monitoruese:

Data	ora	Aktiviteti	Pjesëmarrës

Vëzhgime të përgjithshme

Udhëzime: Vendosni vëzhgimet tuaj mbi vizitën monitoruese. Mund të vendosen disa paragrafë deri në dy faqe. Përfshihen foto, raste studimore dhe të dhëna që ilustrojnë këndvështrimin tuaj.



BASHKIA KORÇË

Çështje të identifikuara dhe veprime që duhet të ndërmerren

Udhëzim: Listoni çështjet ose problemet e identifikuara gjatë vizitës dhe më pas listoni veprimet që duhen ndërmarrë për të zgjidhur apo trajtuar problematikën. Këtu duhet të përfshihet dhe përgjegjësitë individuale të personit përgjegjës se çfarë dhe kur duhet të ndërmerren veprimet për përmirësim.

Çështje të identifikuara	Veprime që duhen ndërmarrë

Vizita e rradhës

Udhëzime: jepen detaje se kur do të jetë koha për vizitën e rradhës. Objektivat e vizitës së rradhës duhet të jenë për të ndjekur çështjet e identifikuar në vizitën e fundit. P.sh nëse cilësia e realizimit të aktiviteteve është një çështje e identifikuar, atëherë do të monitorohen të njëjtat aktivitete për të parë nëse cilësia e realizimit të tyre është përmirësuar.

Detajet e vizitës së rradhës janë:

Duhet të realizohet nga:	
vendi	
Data	
Objektivat	

2. MEKANIZMI I MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT TË SHMFF NË NIVEL QËNDROR, PÛRKATËSISHT ME DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR NË KORÇË DHE VETË SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR



BASHKIA KORÇË

Mekanizmi i monitorimit dhe vlerësimit të SHMFF nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror dhe Drejtoria Rajonale e SHSSH bazohet në Ligjin nr.121/2016 “Për shërbimet e Kujdesit Shoqëror në RSH”, VKM nr. 617, datë 20.10.2021 “Për treguesit statistikorë të vlerësimit e të monitorimit të programeve të Ndhmës Ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore, si edhe periodicitetin e mbledhjes së tyre” (shih modulari nr.3 shërbimet e përkujdesjes shoqërore bashkëngjitur dokumentit).

Drejtoria e Kujdesit Social dhe SHMFF duhet të raportojnë në varësi të periodicitetit të përcaktuar në vendim mbi grupin e synuar, kategoritë e grupeve vulnerabël, fëmijë, gra, të rinj, të moshuar, pak, etj, indikatorët e monitorueshëm dhe specifikime mbi bazë, moshe, gjinie, statusi, nivel bashkie apo shërbimi.

Njëkohësisht *Vendim nr. 136, datë 07.03.2018 “Për funksionimin dhe administrimin e regjistrit elektronik kombëtar të shërbimeve të kujdesit shoqëror”* përcakton dhe regjistrin elektronik si një metodologji të dytë për monitorimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Regjistri është baza elektronike e të dhënave të përfituesve, subjekteve ofruese, institucioneve përgjegjëse, llojit dhe kohëzgjatjes së shërbimeve të kujdesit shoqëror. Ai shërben për ndërtimin e një mekanizmi funksional të referimit, ndjekjes, monitorimit dhe vlerësimit të rastit; identifikimin e rasteve, këshillimin dhe hartimin e planeve individuale të përkujdesjes nga njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit, në përputhje me ligjin e shërbimeve të kujdesit shoqëror; referimin në shërbimet specifike shoqërore të nivelit vendor, rajonal apo kombëtar; lehtësimin e komunikimit, të verifikimit dhe bashkëpunimit me regjistrat e tjerë elektronikë; unifikimin e kompjuterizimin e të dhënave të rasteve dhe përmirësimin e cilësisë së statistikave të harmonizuara, të gjeneruara nga sistemi.

Regjistri elektronik si instrument mundëson përmirësimin e sistemit të vlerësimit/monitorimit, raportimit në të gjitha nivelet, ndjekjen e ecurisë së pagesave lidhur me treguesit, si dhe përmirësimin e auditit dhe kontrollit për të reduktuar numrin e abuzimeve, nëpërmjet prodhimit të raporteve tremujore të performancës së skemës për politikbërësit.

Bashkia Korçë nëpërmjet Drejtorisë së Kujdesit Social dhe SHMFF kujdeset që ky rregjistër të jetë funksional dhe të pasurohet me gjithë informacionin e nevojshëm për shërbimet e ofruara në SHMFF në përputhje me kriteret e VKM¹.

Të dy instrumentat e sipërpërmendur ndihmojnë në ofrimin e kornizës gjithëpërfshirëse të mekanizmit të monitorimit dhe vlerësimit duke e kthyer modelin e pilotuar si një praktikë model në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

MODULAR 3 – SHËRBIMET E PËRKUJDESJES SHOQËRORE

¹ vendim nr. 136, datë 7.3.2018 “Për funksionimin dhe administrimin e regjistrit elektronik kombëtar të shërbimeve të kujdesit shoqëror”



BASHKIA KORÇË

Nr	Grupi i synuar	Indikator i monitorueshëm	Përmbajtja	Specifikime	Periodiciteti
1.	Fëmijë në nevojë	Numri i qendrave/shërbimeve publike të përkujdesjes shoqërore	Tregon numrin e qendrave/shërbimeve publike rezidenciale ose ditore që ofrojnë shërbime të përkujdesjes shoqërore në nivel qarku dhe bashkie.	Sipas llojit të qendrës/shërbimit; Sipas statusit të përfituesit; Në nivel bashkie; Në nivel qarku; Shërbim i ri/ekzistues.	Çdo 2 muaj
2.		Numri i përfituesve të vendosur në qendrat/shërbimet publike	Tregon numrin e përfituesve të shërbimeve sociale në qendrat/shërbimet publike në nivel qarku dhe bashkie.	Sipas grupmoshës; Sipas gjinisë; Sipas gjendjes së aftësisë/aftësive të kufizuara; Sipas statusit (social, arsimor, familjar) të përfituesve.	Çdo 2 muaj
3.		Numri i kërkesave për përfitim të shërbimeve shoqërore në qendrat/shërbimet publike	Tregon numrin e kërkesave të bëra pranë strukturave përkatëse në nivel qarku, bashkie për të përfituar shërbime të përkujdesjes shoqërore në qendrat/shërbimet publike	Sipas llojit të shërbimit që kërkohet; Sipas grupmoshës së kërkuesit; Sipas gjinisë së kërkuesit.	Çdo 2 muaj
4.		Fondi i shpenzimeve në qendrat/shërbimet	Tregon totalin e fondit të shpenzuar në	Sipas llojit të qendrës / shërbimit Sipas statusit të	Çdo 2 muaj



BASHKIA KORÇË

		publike të përkujdesjes shoqërore	qendrat/shërbimet publike të përkujdesjes shoqërore në qark/bashki për periudhën (000/lekë).	përfituesve Sipas burimit të financimit	
5.		Numri i qendrave/shërbim eve jopublike që ofrojnë shërbime të përkujdesjes shoqërore	Tregon numrin e qendrave/shërbime ve jopublike që ofrojnë shërbime për grupin e synuar në qark/bashki	Sipas llojit të shërbimeve që ofrojnë për përfitues të ndryshëm; Në nivel bashkie; Në nivel qarku; Shërbim i ri/ekzistues.	Çdo 2 muaj
6.		Numri i përfituesve përfitues të shërbimeve në qendrat/shërbimet jopublike	Tregon numrin e përfituesve që përfitojnë shërbime shoqërore në qark/bashki në qendrat/shërbimet jopublike.	Sipas statusit (social, arsimor, familjar) të përfituesve; Sipas grupmoshave; Sipas gjinisë; Sipas gjendjes së aftësisë/aftësive të kufizuara.	Çdo 2 muaj
7.		Numri i përfituesve në nevojë	Tregon numrin e identifikuar nga strukturat përkatëse (shtetërore apo OJF) të përfituesve që kanë nevojë për shërbime shoqërore në bashki.	Sipas gjendjes familjare, shoqërore, shëndetësore, arsimimit; Sipas grupmoshës; Sipas gjinisë.	Çdo 2 muaj



BASHKIA KORÇË

8.	Gra në nevojë	Numri i qendrave/shërbimeve publike të përkujdesjes shoqërore	Tregon numrin e qendrave/shërbimeve publike rezidenciale ose ditore që ofrojnë shërbime të përkujdesjes	Sipas llojit të qendrës/shërbimit; Sipas statusit të përfituesve; Në nivel bashkie; Në nivel qarku; Shërbim i	Çdo 2 muaj
			shoqërore për grupin e synuar në nivel qarku dhe bashkie.	ri/ekzistues.	
9.		Fondi i shpenzimeve në qendrat/shërbimet publike të përkujdesjes shoqërore	Tregon totalin e fondit të shpenzuar në qendrat/shërbimet publike të përkujdesjes shoqërore në qark/bashki për periudhën (000/lekë).	Sipas llojit të qendrës/shërbimit; Sipas statusit të përfituesve.	Çdo 2 muaj
10.		Numri i qendrave/shërbimeve jopublike që ofrojnë shërbim të përkujdesjes shoqërore	Tregon numrin e qendrave/shërbimeve jopublike që ofrojnë shërbime për grupin e synuar në qark/bashki.	Sipas llojit të shërbimit që ofrojnë.	Çdo 2 muaj



BASHKIA KORÇË

11.		Numri i përfituesve të shërbimeve të përkujdesjes	Tregon numrin e përfituesve që përfitojnë shërbime të përkujdesjes shoqërore (publike apo jopublike) në qark/bashki .	Sipas llojit të qendrës; Sipas llojit të shërbimit; Sipas grupmoshës; Sipas statusit familjar, shoqëror, shëndetësor etj.; Sipas gjendjes sociale; Sipas vendbanimit; Sipas nivelit arsimor; Sipas statusit të punësimit.	Çdo 2 muaj
12.		Numri i përfituesve në nevojë	Tregon numrin e identifikuar nga strukturat përkatëse (shtetërore apo	Sipas gjendjes familjare shoqërore, shëndetësore, arsimimit;	Çdo 2 muaj
			OJF) të përfituesve që kanë nevojë për shërbime shoqërore në bashki.	Sipas grupmoshës; Sipas gjendjes sociale; Sipas vendbanimit; Sipas nivelit arsimor; Sipas statusit të punësimit.	



BASHKIA KORÇË

13.	Të rinj në nevojë	Numri i qendrave/shërbimeve publike të përkujdesjes shoqërore	Tregon numrin e qendrave/shërbimeve publike rezidenciale ose ditore që ofrojnë shërbime e përkujdesjes shoqërore për grupin e synuar në nivel qarku dhe bashkie.	Sipas llojit të qendrës/shërbimit Sipas statusit të përfituesve Në nivel Bashkie Në nivel Qarku Shërbim i ri/ekzistues	Çdo 2 muaj
14.		Fondi i shpenzimeve në qendrat/shërbimet publike të përkujdesjes shoqërore	Tregon totalin e fondit të shpenzuar në qendrat/shërbimet publike të përkujdesjes shoqërore në qark/bashki në (000/lekë).	Sipas llojit të qendrës/shërbimit; Sipas statutit të përfituesve.	Çdo 2 muaj
15.		Numri i qendrave/shërbimeve jopublike që ofrojnë shërbime të përkujdesjes shoqërore	Tregon numrin e OJF-ve që ofrojnë shërbime për grupin e synuar në qark/bashki.	Sipas llojit të shërbimit që ofrojnë	Çdo 2 muaj
16.		Numri i përfituesve të shërbimeve të përkujdesjes	Tregon numrin e përfituesve që përfitojnë shërbime të përkujdesjes shoqërore (publike	Sipas llojit të qendrës/shërbimit; Sipas grupmoshës; Sipas statusit familjar, shoqëror,	Çdo 2 muaj
			apo OJF) në qark/bashki.	shëndetësor etj.; Sipas gjinisë; Sipas nivelit arsimor.	



BASHKIA KORÇË

17.		Numri i përfituesve në nevojë	Tregon numrin e identifikuar nga strukturat përkatëse (shtetërore apo OJF) të përfituesve që kanë nevojë për shërbime shoqërore në bashki.	Sipas gjendjes familjare, shoqërore, shëndetësore, arsimimit; Sipas grupmoshës; Sipas gjinisë; Sipas vendbanimit.	Çdo 2 muaj
18.	Të moshuar në nevojë	Numri i qendrave/shërbimeve publike të përkujdesjes shoqërore	Tregon numrin e qendrave/shërbimeve publike rezidenciale ose ditore që ofrojnë shërbime të përkujdesjes shoqërore për grupin e synuar në nivel qarku dhe bashkie.	Sipas numrit të përfituesve; Në nivel bashkie; Në nivel qarku; Shërbim i ri/ekzistues.	Çdo 2 muaj
19.		Numri i përfituesve të vendosur në qendrat/shërbimet publike	Tregon numrin e përfituesve të shërbimeve sociale në qendrat/shërbimet publike në nivel qarku dhe bashkie.	Sipas grupmoshës; Sipas gjinisë; Sipas statusit të përfituesve; Sipas gjendjes familjare /shëndetësore/aftësisë; Sipas vendbanimit.	Çdo 2 muaj
20.		Numri i kërkesave për përfitim të shërbimeve shoqërore në qendrat/shërbimet publike	Tregon numrin e kërkesave të bëra pranë strukturave përkatëse në nivel qarku, bashkie për të përfituar shërbime të	Sipas statusit të kërkuarit; Sipas grupmoshës; Sipas gjinisë; Sipas gjendjes familjare/shëndetësore /aftësisë;	Çdo 2 muaj



BASHKIA KORÇË

			përkujdesit shoqëror në qendrat/shërbimet publike	Sipas vendbanimit.	
21.		Fondi i shpenzimeve në qendrat/shërbimet publike të përkujdesjes shoqërore	Tregon totalin e fondit të shpenzuar në qendrat/shërbimet publike të përkujdesjes shoqërore në qark/bashki për periudhën (000/lekë).	Sipas numrit të përfituesve; Sipas llojit të shërbimit; Sipas burimit të financimit.	Çdo 2 muaj
22.		Numri i qendrave/shërbimeve jopublike që ofrojnë shërbime të përkujdesjes shoqërore	Tregon numrin e qendrave/shërbimeve jopublike që ofrojnë shërbime për grupin e synuar në qark/bashki	Sipas llojit të shërbimit që ofrojnë	Çdo 2 muaj
23.		Numri i përfituesve të shërbimeve nga qendrat/shërbimet jopublike	Tregon numrin e përfituesve që përfitojnë shërbime shoqërore në qark/bashki nga qendrat/shërbimet jopublike	Sipas gjendjes së përfituesit Sipas grupmoshave Sipas gjinisë Sipas vendbanimit	Çdo 2 muaj
24.		Numri i përfituesve në nevojë	Tregon numrin e identifikuar nga strukturat përkatëse (shtetërore apo OJF) të përfituesve që kanë nevojë për shërbime shoqërore në bashki.	Sipas gjendjes familjare, shëndetësore; Sipas grupmoshës; Sipas gjinisë; Sipas vendbanimit.	Çdo 2 muaj



BASHKIA KORÇË

25.	Persona me aftësi të kufizua	Numri i qendrave/shërbimeve publike të përkujdesjes	Tregon numrin e qendrave/shërbimeve publike rezidenciale ose	Sipas llojit të shërbimit; Në nivel bashkie; Në nivel qarku;	Çdo 2 muaj
	ra	shoqërore	ditore që ofrojnë shërbime të përkujdesjes shoqërore për grupin e synuar në nivel qarku dhe bashkie.	Shërbim i ri/ekzistues.	
26.		Numri i përfituesve të vendosur në qendrat/shërbimet publike	Tregon numrin e përfituesve të shërbimeve sociale në qendrat/shërbimet publike në nivel qarku dhe bashkie.	Sipas llojit të aftësive të kufizuara; Sipas grupmoshës; Sipas gjinisë; Sipas gjendjes familjare; Sipas vendbanimit.	Çdo 2 muaj
27.		Numri i kërkesave për përfitim të shërbimeve shoqërore në qendrat/shërbimet publike	Tregon numrin e kërkesave të bëra pranë strukturave përkatëse në nivel qarku, bashkie për të përfituar shërbime të përkujdesjes shoqërore në qendrat/shërbimet publike.	Sipas statusit të kërkesit; Sipas grupmoshës; Sipas gjinisë.	Çdo 2 muaj



BASHKIA KORÇË

28.		Fondi i shpenzimeve në qendrat/shërbimet publike të përkujdesjes shoqërore	Tregon totalin e fondit të shpenzuar në qendrat/shërbimet publike të përkujdesjes shoqërore një qark/bashki (në 000/lekë).	Sipas llojit të shërbimit; Sipas numrit të përfituesve; Sipas llojit financimit.	Çdo 2 muaj
29.		Numri i qendrave/shërbimeve jopublike që ofrojnë shërbim të përkujdesjes shoqërore	Tregon numrin e qendrave/shërbimeve jopublike që ofrojnë shërbime për grupin e synuar në qark/bashki	Sipas llojit të shërbimit që ofrojnë; Sipas vendbanimit.	Çdo 2 muaj
30.		Numri i përfituesve të shërbimeve nga qendrat/shërbimet jopublike	Tregon numrin e përfituesve që përfitojnë shërbime shoqërore në qark/bashki nga qendrat/shërbimet jopublike	Sipas llojit të aftësive të kufizuara; Sipas grupmoshave; Sipas gjinisë; Sipas gjendjes familjare; Sipas vendbanimit.	Çdo 2 muaj
31.		Numri i përfituesve në nevojë	Tregon numrin e identifikuar nga strukturat përkatëse (shtetërore apo OJF) të përfituesve që kanë nevojë për shërbime shoqërore në bashki .	Sipas gjendjes familjare, shëndetësore; Sipas grupmoshës; Sipas gjinisë; Sipas llojit të aftësive të kufizuara.	Çdo 2 muaj